



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Shkurt 2022

Nr: 59

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS SË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore” dhe të nenit 19, pikat 1, shkronja “l”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V Ë R E N:

Referuar vendimit nr.100, datë 09.02.2022 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të zgjedhjeve të pjesshshme për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022”, lind e nevojshme miratimi i strukturës buxhetore për zgjedhjet e pjesshshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022 .

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronjat “k”, “l” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



Data: 10 Shkurt 2022

Nr. 59

Vendim “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022”.

V E N D O S I:

1. Miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI



	AKTIVITETET	Buxheti
I	PAGAT	48,628,256
1	Paga personel i përkohshëm në KQZ	14,868,600
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore për personelin e përkohshëm	2,483,056
3	Shpërblimi i anëtareve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, trajnuesve të KZAZ,KQV,GNV	31,276,600
II	MALLRA	31,071,525
1	Materiale (prodhime specifike) të rëndësishme	21,408,200
2	Materiale (prodhime), brenda vendit	1,839,000
3	Materiale të tjera (karburant)	1,521,000
4	Materiale (shtypshkrime)	2,980,650
5	Materiale (kancelari)	1,780,675
6	Materiale anti covid-19 për KQZ, KZAZ, KQV dhe GNV	1,542,000
III	SHERBIME	110,300,218
1	Shërbime udhëtim e dieta	919,705
2	Shërbime qeramartje	4,392,400
3	Shërbime për fushatwn edukuese, informuese dhe sensibilizuese	8,067,625
4	Operatore për përdorimin e paisjes PEI ditën e votimit	14,886,540
5	Shërbime dhe suport te teknologjisë së informacionit IT	55,285,000
5.1	Shërbime dhe suport IT për PEI (Identifikimi Eletronik)	35,000,000
5.2	Shërbime dhe suport IT për PEVN (Votimi Eletronik)	10,000,000
5.3	Shërbime të tjera	10,285,000
6	Shërbime për regjistrimin dhe transmetimin e numërimit të votave	23,513,948
7	Shërbime për shpenzime të transportit të bazës materiale	3,235,000
	TOTALI	190,000,000

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

